

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"DSG Care Sale" SHPK**

Sot me daten 01/05/2023 (dymijë e njëzet e tre ), ne ortaket themelues :

- **1 Z. SHERIDAN XHEBEXHIA**, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 12 Korrik 1990, lindur në Krumë, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Letërnjoftimit (kartë identiteti) me Nr. J00712048V.
  - **2 Z. GERALT XHEBEXHIA**, shtetas Shqiptar , i datëlindjes 16 Maj 1995, lindur në Krumë, disponues i letërnjoftimit (kartë identiteti), me Nr. J50516030P.
- Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "DSG Care Sale" SHPK.*

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet " DSG Care Sale" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, Valias,Tiranë,Ndërtesë me nr pasurie 54/82, vol 10, fq 146, zona kadastrale 1649.

**NENI 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen e : eksport ,import, tregti, dhënie me qera të automjeteve të tonazhëve të ndryshme,agjensi imobiliare, blerje, shitje, dhënie me qera , ndërmjetësim për shitje dhe blerje të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme të llojeve të ndryshme, ndërtesa, apartamente, toka truall dhe arë, pyje,njësi tregtare,garazhde.Ofrimin e shërbimit të menaxhimit të mardhënies me publikun, marketing dixhital nëpërmjet ofrimit të dizenjimit dhe menaxhimit të faqeve të rrjeteve sociale për qëllime marketing. Shërbime marketing online. Krijim, menaxhim, dhe shitje të faqeve website. Çdo gjë që i shërben aktivitetit dhe cdo gjë që lejon legjislacioni shqiptar.

**NENI 4**  
**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**





Kapitali themeltar i shoqërisë "DSG Care Sale" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 2 kuota, me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) secila.

Kontributi i ortakëve është i ndare si vijon:

- 1. SHERIDAN XHEBEXHIA zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.**
- 2. GERALT XHEBEXHIA, zotëron 1 kuotë baraz me 50 % të kapitalit.**

#### **NENI 5**

#### **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

#### **NENI 6**

#### **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administratorë të shoqërisë do të jenë

- 1- **Z. SHERIDAN XHEBEXHIA**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.
- 2- **Z. GERALT XHEBEXHIA**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë përsëritje.

Administratorët emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqësojnë me tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratorët kanë të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratorët mund të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratorët janë përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

**Të dy administratorët mund të veprojnë bashkërisht ose vec e vec.**

#### **NENI 7**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqëritë Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 8**

#### **NDARJA E FITIMEVE**



Fitimi që do të shpërndahe përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

**Neni 9**  
**LIKUJDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**  
**MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Tiranë për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË**  
**"DSG Care Sale" SH.P.K**

**SHERIDAN XHEBEXHIA**



**GERALT XHEBEXHIA**



THEMELUES  
"DSG Care Sale"